



GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI

Gjashtëmuji i parë 2021

DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

Gusht 2021¹

¹ Për shkak të pandemisë së SARS-CoV-2, informacioni i këtij vrojtimi është mbledhur duke përdorur forma të ndryshme, në respektim të masave parandaluese për të minimizuar përhapjen (intervista në distancë fizike, postë elektronike dhe telefon). Ky vrojtim mbulon zhvillimet mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e ndërmarrjeve për gjashtëmuji i parë 2021, si edhe pritshmëritë për gjashtëmuji i dytë të vitit.

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit..... | 2 |
| Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri..... | 4 |
| 1- Organizimi dhe fusha e veprimit | 4 |
| 2- Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë | 7 |
| 3- Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve | 12 |
| 4- Struktura e huasë | 14 |
| 5- Ngarkesa e huasë..... | 16 |
| 6- Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen..... | 19 |

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit

Për këtë vrojtimit u përdor një kampion prej 1,374 ndërmarrjesh të madhësive të ndryshme të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Nga këto, rreth 82% iu përgjigjën plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të pyetësorit. Vlerësimet në vrojtimit janë realizuar mbi bazën e numrit të ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit dhe klasifikimit përkatës të tyre.

• GJENDJA FINANCIARE

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2021 (më tej, "*periudha*"), ndërmarrjet e vrojtuar **theksojnë se "situata e krijuar nga pandemia", vijon të ketë ndikim në aktivitetin e tyre, duke ndikuar edhe problematikat e tjera me të cilat ato janë përballur** dhe që lidhen kryesisht me "konkurrencën" dhe "gjetjen e tregut", "aksesin në financim", "kostot e financimit" dhe "disponueshmërinë e stafit të kualifikuar". Më të ndjeshme ndaj zhvillimeve të periudhës janë shfaqur ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha.

Ecuria e nivelit të shitjeve dhe e rezultatit financiar paraqitet e përmirësuar në krahasim me gjashtëmujorin e dytë 2020, ndonëse ndërmarrjet e vogla e të mesme vijnë të paraqiten me balanca neto negative. **Mbi 87% e ndërmarrjeve, në secilin grup sipas madhësisë, kanë raportuar fitim gjatë periudhës.** Krahasuar me periudhën paraardhëse, pesha e ndërmarrjeve që kanë raportuar fitim ka shënuar rritje për të tri grupet e ndërmarrjeve. **Pritshmëritë për gjashtëmujorin e ardhshëm për nivelin e shitjeve të përgjithshme dhe të rezultatit financiar** paraqiten mjaft optimiste për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

Për sa i takon zgjerimit të veprimtarisë apo rritjes së investimeve, ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha shprehen për një zgjerim të veprimtarisë, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme vijnë të paraqesin një ngushtim të lehtë për periudhën. Pandemia vijon të ketë ndikim në vendimmarrjen e ndërmarrjeve lidhur me investimet apo zgjerimin e aktivitetit të tyre, gjithsesi rritja gjashtëmujore e kësaj balance jep sinjale të mira rigjallërimi. Për sa i përket *pritsmërive* për gjashtëmujorin e ardhshëm, të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve shprehen pozitive për periudhën në vijim.

Gjatë periudhës, **më pak se gjysma e totalit të ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit deklarojnë se e kanë financiar veprimtarinë e tyre nëpërmjet shitjeve.** Mbështetja vetëm në këtë burim është ngushtuar për të tre grupet e ndërmarrjeve. Ndërkohë, prirja e *kombinimit të burimeve të financimit* vijon të zërë një peshë të konsiderueshme për periudhën dhe është zgjeruar për të gjitha llojet e ndërmarrjeve. Peshën kryesore në këtë aspekt e zë financimi i realizuar nëpërmjet *kombinimit të shitjeve me rezervat e mbartura*.

• HUAMARRJA

Rreth 40% e totalit të ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit (454 ndërmarrje) deklarojnë se kanë aktualisht hua për të paguar. Kjo peshë ka shënuar një rënie prej 0.9 pikë përqindjeje (pp) krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por është rritur me 0.7 pp krahasuar me një vit më parë. Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ka rezultuar në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha krahasuar me periudhën e kaluar, përkatësisht me 3.6 pp dhe 0.8 pp, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme kanë një rritje prej 0.5 pp.

Në total, burimet formale të huamarrjes (nga banka dhe institucione financiare jobanka) janë përdorur nga 92% e ndërmarrjeve huamarrëse që i janë përgjigjur pyetësorit, 2 pp më tepër në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm. Ndër to, rreth 90% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar sektorit bankar si burim i vetëm huamarrjeje, 2.1 pp më tepër në krahasim me gjysmën e dytë të vitit 2020. Kombinimi i burimeve *formale* dhe *atyre joformale* është përdorur nga 3.4% e ndërmarrjeve.

Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, pesha e totalit të ndërmarrjeve huamarrëse të cilat kanë marrë hua për kryerjen e një investimi, ka shënuar një rënie për ndërmarrjet e vogla e të mesme, ndërkohë që huamarrja me qëllim përballimin e shpenzimeve afatshkurtra ka vijuar të rritet gjatë periudhës për ndërmarrjet e të gjitha madhësive. Rreth 77% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 85% e ndërmarrjeve të mesme dhe 87% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të *përshtatshëm* nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë është rritur për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

Huamarrja e ndërmarrjeve kryhet vetëm në *monedhën vendase* për 60% të ndërmarrjeve të vogla, 65% të ndërmarrjeve të mesme dhe 45% të ndërmarrjeve të mëdha, ndërsa pjesa tjetër është në valutë dhe/ose e kombinuar. Huamarrja *në valutë*, kryesisht në euro, rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (rreth 41%) dhe më pak nga ndërmarrjet e vogla e të mesme (përkatësisht 36% dhe 31% e tyre).

Vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për rreth 74% të totalit të ndërmarrjeve huamarrëse dhe pothuaj e njëjtë me vlerën e kapitalit për 13% të tyre. Të analizuar sipas madhësisë, raporti "hua/kapital" ka rezultuar më i lartë te ndërmarrjet e vogla e të mesme, ku përkatësisht 26% dhe 34% e tyre shprehen se ky raport është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit, duke nënkuptuar një ngarkesë më të lartë me borxh. Për këtë gjashtëmujor, ky raport është rritur për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh është rritur për të gjithë sektorët e analizuar dhe paraqitet më e lartë tek ndërmarrjet e sektorit të ndërtimit dhe ato të tregtisë.

- MARRËDHËNIA ME BANKAT

Vështirësia e procesit të huamarrjes nga bankat vlerësohet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", i pandryshuar në krahasim me periudhën paraardhëse. *Marrëdhënia me bankat* vijon të vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme". Lidhur me elementet që vështirësojnë përfitimin e një huaje bankare, *kostoja e lartë e kredisë* vijon të cilësohet si elementi kryesor, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla. Gjithsesi, vlerësimi për këtë element ka rezultuar në rënie për këtë gjashtëmujor për ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha.

Lidhur me planifikimin e një huamarrjeje në të ardhmen, thuhet gjysma e ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit deklarojnë se "*nuk ka asnjë mundësi*" që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme. Kjo peshë ka shënuar rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve në krahasim me periudhat paraardhëse. Nga ana tjetër, vërehet një rritje e peshës së këtyre ndërmarrjeve që pohojnë se "*ka pak mundësi*" të marrin një kredi në gjysmën e dytë të vitit 2021, si edhe e peshës së ndërmarrjeve të vogla e të mëdha të cilat shprehen se "*ka shumë mundësi*" që diçka e tillë të ndodhë në periudhën pasardhëse. Pesa e ndërmarrjeve të cilat kanë zgjedhur alternativën "*është e sigurt*" është rritur lehtësisht për ndërmarrjet e të gjitha madhësive, ndonëse kjo zgjedhje ruan peshën më të vogël.

Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri

Karakteristikat e kampionit të vrojtuar². Në gjashtëmujorin e parë 2021 (më tej “periudha”), vrojtimi u realizua mbi një kampion prej 1374 ndërmarrjesh, të shpërndara në 12 qarqet e vendit. Pjesa kryesore e këtyre ndërmarrjeve (rreth 78%) janë përqendruar kryesisht në 4 qarqe, përkatësisht në: Tiranë (rreth 53%), Durrës (rreth 15%), Fier (rreth 6%) dhe Shkodër (rreth 4%).


Në totalin e kampionit të përzgjedhur, rreth 82% e ndërmarrjeve (gjithsej 1127 ndërmarrje) i janë përgjigjur pyetjeve të vrojtimit dhe analiza e rezultateve mbështetet në këto përgjigje. Analiza e mëposhtme është organizuar kryesisht bazuar në ndarjen sipas madhësisë së ndërmarrjeve.

1. Organizimi dhe fusha e veprimit

1.1 Shpërndarja sektoriale dhe madhësia e ndërmarrjeve


Për periudhën, në ndarjen sipas sektorëve, rreth 36% e ndërmarrjeve i përkasin sektorit të *industrisë*, rreth 30% sektorit të *shërbimeve*, rreth 14% sektorit të *ndërtimit* dhe rreth 19% sektorit të *tregtisë*. Sipas madhësisë, rreth 23% e ndërmarrjeve klasifikohen si *ndërmarrje të vogla* (5-19 persona të punësuar), rreth 16% si *ndërmarrje të mesme* (20-49 të punësuar) dhe rreth 61% si *ndërmarrje të mëdha* (mbi 50 të punësuar). Në grupin e *ndërmarrjeve të vogla*, peshën kryesore e zënë ndërmarrjet që operojnë në sektorin e shërbimeve (rreth 40%), ndjekur nga sektori i tregtisë (rreth 27%). Nga ana tjetër, në grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, peshën më të lartë e kanë ndërmarrjet e sektorit të industrisë (përkatësisht prej rreth 39% dhe 40%) dhe ato të sektorit të shërbimeve (respektivisht 29% dhe 27%).

Grafik 1.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 1.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe sektorëve të ekonomisë



1.2 Sigurimi i lëndës së parë dhe shitja e produkteve


Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (respektivisht rreth 57% e ndërmarrjeve të vogla, 48% e atyre të mesme dhe 36% e atyre të mëdha) e sigurojnë mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit. Krahasuar me periudhën paraardhëse (gjashtëmujorin e dytë 2020), ky tregues është ulur me 6 pp në rastin e

² Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së ndërmarrjeve kryhet që prej gjashtëmujorit të dytë 2010, me një frekuencë gjashtëmujore. Fillimisht, ky vrojtimit u hodh në terren me një kampion të përzgjedhur prej 700 ndërmarrjesh me shitje neto vjetore më të lartë (ndërmarrje të mëdha). Më tej, në vitin 2016, kampioni u zgjerua në rreth 1200 ndërmarrje të mëdha, të mesme e të vogla, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin.


ndërmarrjeve të vogla dhe me 1.8 pp për ndërmarrjet e mëdha, ndërkohë që është rritur me 4.1 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme. Nga ana tjetër, rreth 37% e ndërmarrjeve të mëdha sigurojnë *deri në 20% të lëndës së parë brenda vendit*, me një rritje gjashtëmujore prej 1.9 pp.

Shitja e produkteve vijon të mbetet kryesisht brenda vendit, ku rreth 83% e ndërmarrjeve të vogla, 67% e ndërmarrjeve të mesme dhe 54% e ndërmarrjeve të mëdha, kanë deklaruar se kanë shitur shumicën e produkteve në tregun vendas (mbi 80% të volumit të produkteve). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, ka pasur një rritje të peshës së ndërmarrjeve të mesme që i shesin produktet e tyre kryesisht brenda vendit (me 3 pp), ndërkohë që pesha e ndërmarrjeve të vogla e të mëdha që deklarojnë një gjë të tillë ka shënuar një rënie të lehtë (përkatesisht me 2.6 dhe 1 pp).

Grafik 1.3 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas peshës së blerjes së lëndës së parë brenda vendit



Grafik 1.4 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas peshës së shitjeve brenda vendit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Duke i analizuar përgjigjet sipas sektorëve, rezulton se sektori i ndërtimit ka një varësi më të madhe ndaj lëndës së parë të siguruar në vend, ku rreth 72% e ndërmarrjeve të këtij sektori siguron mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit. Kjo peshë është ulur me 6.7 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me 3.1 pp krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, sektori i industrisë shfaq varësi më të ulët, ku 53% e ndërmarrjeve të këtij sektori sigurojnë *vetëm 20% të lëndës së parë brenda vendit*. Pesha e këtyre ndërmarrjeve ka shënuar një rritje gjashtëmujore prej 1.6 pp, ndërsa në terma vjetorë kjo rritje është 4.7 pp.

Tabelë 1.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve dhe përqindjes së blerjes së lëndës së parë brenda vendit

| | | Deri në 20% | 20-50% | 50-80% | Mbi 80% |
|-----------------|------------------|-------------|--------|--------|---------|
| Industri | 6MII 2019 | 48.9% | 8.6% | 14.7% | 27.8% |
| | 6MI 2020 | 47.9% | 13.4% | 13.4% | 25.3% |
| | 6MII 2020 | 51.0% | 13.1% | 13.1% | 22.9% |
| | 6MI 2021 | 52.6% | 14.1% | 9.1% | 24.2% |
| Shërbime | 6MII 2019 | 18.2% | 5.7% | 13.1% | 63.0% |
| | 6MI 2020 | 16.7% | 5.6% | 12.0% | 65.7% |
| | 6MII 2020 | 20.1% | 6.7% | 10.2% | 63.0% |
| | 6MI 2021 | 18.4% | 6.4% | 14.3% | 60.8% |
| Ndërtim | 6MII 2019 | 1.3% | 3.2% | 19.0% | 76.6% |
| | 6MI 2020 | 3.7% | 2.5% | 18.4% | 75.5% |
| | 6MII 2020 | 3.0% | 1.2% | 16.8% | 79.0% |
| | 6MI 2021 | 4.4% | 3.1% | 20.1% | 72.3% |
| Tregti | 6MII 2019 | 30.6% | 14.5% | 19.2% | 35.8% |
| | 6MI 2020 | 32.7% | 19.5% | 14.6% | 33.2% |
| | 6MII 2020 | 31.4% | 20.3% | 16.4% | 31.9% |
| | 6MI 2021 | 29.7% | 24.7% | 16.4% | 29.2% |

Burimi: Banka e Shqipërisë.


1.3 Elementet kufizuese në aktivitetin e ndërmarrjeve³

Gjatë periudhës, vlerësimin më të lartë për ndikimin në biznes vijon ta ketë "situata e krijuar nga pandemia⁴", e cila ka ndikuar edhe problematikat e tjera me të cilat janë përballur ndërmarrjet. Në vijim, ndërmarrjet e vrojtura raportojnë se "konkurrenca" dhe "gjetja e tregut" vijnë të mbeten sfidë për ushtrimin e aktivitetit. Rëndësia e elementit të konkurrencës ka shënuar rritje në krahasim me periudhën e mëparshme për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, në mënyrë të ngjashme me gjetjen e tregut. Elemente të cilat kanë shfaqur rritje në vlerësim gjatë kësaj periudhe janë "aksesi në financim", "kosto e financimit" dhe "disponueshmëria e stafit të kualifikuar", veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha.

³ Ndërmarrjet kanë vlerësuar rëndësinë e disa problemeve të caktuara sipas një shkalle nga 1 deri në 10, ku 1 është shkalla më e ulët dhe 10 është shkalla më e lartë e vështirësisë. Për të agreguar përgjigjet për secilën çështje të vlerësuar, është llogaritur një mesatare e peshuar për të gjitha ndërmarrjet e përgjigjura, duke peshuar përgjigjet e tyre me shkallët e vlerësimit (1-10).

⁴ Kjo problematikë është specifikuar në alternativën "Të tjera" dhe është plotësuar nga vetëm 3% e kampionit të ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit. Në gjashtëmujorin e parë 2020, kjo problematikë ishte specifikuar nga 37% e kampionit të përgjigjur, ndërsa në gjashtëmujorin e dytë 2020, 19% e ndërmarrjeve e kishin specifikuar këtë problematikë.

Grafik 1.5. Vlerësimi i ndikimit të disa faktorëve në veprimtarinë e ndërmarrjes



Burimi: Banka e Shqipërisë.


2. Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë

2.1 Monedha e kryerjes së veprimtarisë

Euroizimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme vijoi të mbetet i ulët, por është më i ndjeshëm tek ndërmarrjet e mëdha. Kështu, rreth 13% e ndërmarrjeve të vogla dhe 20% e atyre të mesme deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë *plotësisht* ose *kryesisht*⁵ në valutë. Ky tregues është rreth 36% tek ndërmarrjet e mëdha, me një rritje prej 1.8 pp për periudhën.

⁵ Mbi 50% të veprimtarisë në valutë.

Grafik 2.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe monedhës së kryerjes së veprimtarisë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2 Ecuria e shitjeve, rezultati financiar dhe zgjerimi i veprimtarisë

Gjatë periudhës, niveli i shitjeve ka rënë për ndërmarrjet e vogla e të mesme, por ka shënuar rritje për ndërmarrjet e mëdha. Kështu, ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme vijojnë të raportojnë *ulje të nivelit të shitjeve* me një balancë neto negative prej përkatësisht [19.2%] dhe [20.6%], por gjithsesi në përmirësim në krahasim me dy gjashtëmujorët e kaluar, të cilët reflektuan qartë gjendjen e veshtirë të krijuar nga pandemia. Situata është paraqitur e ndryshme për ndërmarrjet e mëdha, të cilat kanë shënuar një balancë neto pozitive të shitjeve prej 4.8%, duke treguar një rritje të shitjeve të përgjithshme pas dy gjashtëmujorësh me rënie. Për sa i përket *pritshmërive për ecurinë e mëtejshme të nivelit të shitjeve*, të gjitha ndërmarrjet (pavarësisht madhësisë) shprehen mjaft optimiste për gjashtëmujorin e dytë 2021. Më konkretisht, ndërmarrjet e mesme kanë një balancë neto pozitive prej 56.1%, ndjekur nga ndërmarrjet e mëdha, për të cilat balanca pozitive është 51.3%, dhe ndërmarrjet e vogla, me një balancë prej 49.2%.


Grafik 2.2 Balanca neto e shitjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (rritje e shitjeve/rritje e pritshmërive të shitjeve) dhe përgjigjeve negative (rënie e shitjeve/rënie e pritshmërive mbi shitjet) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

Grafik 2.3 Balanca neto e pritshmërive të shitjeve




Në shumicë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme raportojnë rënie të rezultatit financiar, ndërsa ndërmarrjet e mëdha kanë kaluar në territor pozitiv. Kështu, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vlerësojnë *rënie të rezultatit financiar*, me një balancë neto negative prej përkatësisht [21.2%] dhe [22.3%], por e ngushtuar ndaj dy periudhave paraardhëse. Ndërmarrjet e mëdha deklarojnë një balancë pozitive të rezultatit financiar prej 2.9%, pas dy gjashtëmujorësh në të cilët raportohej rënie. *Pritshmëritë për gjashtëmujorin e ardhshëm* paraqiten mjaft optimiste për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

Grafik 2.4 Balanca neto e rezultatit financiar



Grafik 2.5 Balanca neto e rezultatit financiar të pritshëm në gjashtëmuorin e ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.


Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (rritje e rezultatit financiar/rritje e pritshmërive) dhe përgjigjeve negative (rënie e rezultatit financiar/rënie e pritshmërive) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

Vlerësimi i ndërmarrjeve për rritjen e investimeve dhe zgjerimin e veprimtarisë sinjalizon zhvillime pozitive. Ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha kanë shënuar balanca neto pozitive prej 3.8% dhe 10.7%. Ndërsa, ndërmarrjet e mesme vijojnë të pohojnë një balancë negative prej [0.6%]. Pandemia vijon të ketë ndikim në vendimmarrjen e ndërmarrjeve lidhur me investimet apo zgjerimin e aktivitetit të tyre, gjithsesi rritja gjashtëmuore e kësaj balance jep sinjale të mira rigjallërimi. Për gjashtëmuorin e ardhshëm, balancat neto të përgjigjeve kanë rezultuar pozitive për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke nënkuptuar pritshmëri për investim apo zgjerim të mëtijshëm të veprimtarisë. Në krahasim me periudhat paraardhëse të vrojtuar, këto pritshmëri janë më optimiste edhe të krahasuara me periudhën para pandemisë.

Grafik 2.6 Balanca neto e zgjerimit të veprimtarisë



Grafik 2.7 Balanca neto e zgjerimit të veprimtarisë në gjashtëmuorin e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (zgjerim i veprimtarisë/pritshmëri për zgjerim apo investim) dhe përgjigjeve negative (ngushtim i veprimtarisë/pritshmëri për ngushtim) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.


2.3 Niveli i shitjeve dhe rezultati financiar

Ecuria e agreguar e nivelit të shitjeve të përgjithshme është analizuar nëpërmjet një indeksi⁶, i cili peshon përgjigjet e ndërmarrjeve sipas intervaleve të ndryshme dhe i grupon ato sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe sipas sektorëve.


⁶ Koeficientët e peshimit sipas intervaleve të shitjeve të përgjithshme janë: "Deri në 10 milionë lekë" = 0; "10-49 milionë lekë" = 0.25; "50-99 milionë lekë" = 0.5; "100-500 milionë lekë" = 0.75; "Mbi 500 milionë lekë" = 1. Rritja/ulja e vlerës së këtij indeksi nënkupton një rritje/ulje të nivelit të shitjeve të përgjithshme të ndërmarrjeve.

Ecuria e indeksit të shitjeve ka vijuar të përmirësohet gjatë periudhës në krahasim me gjashtëmuajorin e dytë të 2020, ndonëse ende nuk ka arritur në nivelin e periudhës para pandemisë. Në ndarjen sipas madhësisë, ecuria e vlerave të indeksit tregon që vlera e përgjithshme e shitjeve për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme ka shënuar rritje, ndërkohë që ka ngelur e pandryshuar për ndërmarrjet e mëdha. Indeksi është rritur për të tre madhësitë e ndërmarrjeve edhe në krahasim me një vit më parë. Një rritje gjashtëmuajore dhe vjetore vërehet në të gjithë sektorët e ekonomisë. Sipas këtij indeksi, vlerat më të larta të shitjeve janë realizuar nga sektori i ndërtimit dhe ai i tregtisë, ndërkohë që vlerat më të ulëta vijnë në mbeten në sektorin e shërbimeve.

Grafik 2.8 Indeksi i përgjithshëm i shitjeve sipas madhësisë së ndërmarrjeve




Grafik 2.9 Indeksi i shitjeve të përgjithshme sipas sektorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Lidhur me rezultatin financiar në gjashtëmuajorin e parë 2021, në grupin e ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit⁷, mbi 87% e secilit grup sipas madhësisë kanë raportuar fitim gjatë periudhës. Kjo peshë ka rezultuar më e lartë për ndërmarrjet e mëdha (rreth 92%) dhe më e ulët tek ato të mesme (rreth 87%). Krahasuar me periudhën paraardhëse, pesha e ndërmarrjeve që kanë raportuar fitim ka shënuar rritje për ndërmarrjet e vogla.

Grafik 2.10 Rezultati financiar sipas madhësisë së ndërmarrjeve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për ndërmarrjet të cilat raportojnë fitim, ndërmarrjet e vogla e të mesme kanë një balancë negative të shitjeve dhe të rezultatit financiar, ndërsa zgjerimi i veprimtarisë paraqitet me balanca pozitive


⁷ Janë përgjigjur 966 ndërmarrje ose rreth 70% e kampionit.

për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha. Në këtë gjashtëmuor, balancat neto të ndërmarrjeve të mëdha janë pozitive lidhur me shitjet dhe rezultatin financiar, në ndryshim me gjashtëmuorin e dytë 2020. Për sa i përket pritshmërive për gjashtëmuorin e ardhshëm, ndërmarrjet me fitim të të gjitha madhësive paraqiten mjaft optimiste në krahasim me periudhën e mëparshme, veçanërisht mbi ecurinë e shitjeve dhe të rezultatit financiar.

Grafik 2.11 Balancat neto për ndërmarrjet me fitim (6mI 2021, djathtas)




Grafik 2.12 Balancat neto për pritshmëritë e ndërmarrjeve me fitim




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Për ndërmarrjet të cilat raportojnë humbje, të tre grupet e ndërmarrjeve raportojnë balanca negative për nivelin e shitjeve, rezultatin financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë apo rritjen e investimeve gjatë periudhës. Gjithsesi, këto balanca paraqiten të ngushtuara në krahasim me periudhën paraardhëse. Pritshmëritë e ndërmarrjeve me humbje kanë kaluar në një terren pozitiv, duke u paraqitur mjaft optimiste për gjashtëmuorin pasues lidhur me nivelin e ardhshëm të shitjeve, rezultatin financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

Grafik 2.13 Balancat neto për ndërmarrjet me humbje



Grafik 2.14 Balancat neto për pritshmëritë e ndërmarrjeve me humbje




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.4 Financimi i veprimtarisë

Gjatë periudhës, rreth 46% e ndërmarrjeve kanë vijuar të financojnë veprimtarinë e tyre vetëm nëpërmjet shitjeve (52% e ndërmarrjeve të vogla, 43% e ndërmarrjeve të mesme dhe 45% e ndërmarrjeve të mëdha), **duke shënuar rënie për të gjitha grupet e ndërmarrjeve sipas madhësisë.** Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit vijon të zërë një peshë të konsiderueshme për periudhën, duke u

zgjerruar për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Peshën kryesore të tyre e zë financimi i realizuar nëpërmjet kombinimit të shitjeve me rezervat e mbartura.

Grafik 2.15 Financimi i veprimitarisë sipas madhësisë së ndërmarrjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve

Rreth 40% e totalit të ndërmarrjeve që janë përgjigjur⁸ (gjithsej 454 ndërmarrje) pohojnë që kanë një hua për të paguar. Kjo peshë ka shënuar një rënie prej 0.9 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por është rritur me 0.7 pp krahasuar me një vit më parë. Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ka rezultuar në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha, përkatësisht me 3.6 pp dhe 0.8 pp, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme kanë një rritje prej 0.5 pp. Në ndarjen sipas sektorëve, pesha më e lartë e ndërmarrjeve huamarrëse rezulton në sektorin e tregtisë (për rreth 51%), ndonëse në rënie për periudhën, ndjekur nga sektori i ndërtimit (për rreth 42%).

Tabelë 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe huamarrjes

| Ndërmarrjet huamarrëse sipas madhësisë | Nr. i ndërmarrjeve | | Pesha ndaj totalit të grupit | |
|--|--------------------|------------|------------------------------|--------------|
| | 6MII 2020 | 6MI 2021 | 6MII 2020 | 6MI 2021 |
| Të vogla | 86 | 74 | 32.1% | 28.5% |
| Të mesme | 81 | 73 | 40.1% | 40.6% |
| Të mëdha | 299 | 306 | 45.6% | 44.7% |
| Total ndërmarrje | 466 | 454 | 41.2% | 40.3% |

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza e mëposhtme është realizuar duke u mbështetur vetëm në përgjigjet e ndërmarrjeve huamarrëse.


3.1 Burimi i huasë

Rreth 90% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar sektorit bankar si burim huamarrje, ndërsa thujse 5% e tyre kanë përdorur një kombinim burimesh. Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse nga bankat është rritur me 2.1 pp në krahasim me gjysmën e dytë të vitit 2020. Të ndara sipas madhësisë, rezulton se rreth 88% e ndërmarrjeve të vogla, 93% e atyre të mesme dhe 90% e ndërmarrjeve të mëdha i janë drejtuar vetëm bankave si burim huamarrje. Kjo peshë ka vijuar të rritet për ndërmarrjet e

⁸ Duke marrë në konsideratë kampionin e plotë prej 1374 ndërmarrjesh, 1127 prej tyre ose rreth 82% kanë dhënë përgjigje.

vogla dhe ka shënuar gjithashtu rritje edhe për ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Përveç bankave, një pjesë e ndërmarrjeve i janë drejtuar edhe institucioneve financiare jobanka ose kanë kombinuar disa burime formale me të tjera (si hua nga persona fizikë, kompani të tjera, mall i papaguar).

Grafik 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas burimit të huasë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në total, *burimet formale të huamarrjes* (nga banka dhe institucione financiare jobanka) janë përdorur nga 92% e ndërmarrjeve huamarrëse që i janë përgjigjur pyetësorit (rreth 93% e ndërmarrjeve të vogla, 96% e ndërmarrjeve të mesme dhe 92% e atyre të mëdha), 2 pp më tepër në krahasim me gjashtëmujorin e mëparshëm. Kombinimi i burimeve formale me ato të formave të tjera, është përdorur nga 3.4% e ndërmarrjeve.

3.2 Qëllimi i huasë

Huamarrja e ndërmarrjeve të të gjitha madhësive me qëllim përballimin e shpenzimeve afatshkurtra ka shënuar rritje gjatë periudhës. Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për kryerjen e një investimi ka shënuar një rënie për ndërmarrjet e vogla e të mesme. Huamarrja për të cilën janë kombinuar disa qëllime përdorimi, ku peshën kryesore e zënë dy qëllimet e sipërpërmendura, ka pësuar rënie për ndërmarrjet e mëdha.

Grafik 3.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas qëllimit të përdorimit të huasë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3 Mjaftueshmëria e huasë

Gjatë periudhës, më shumë se 3/4 e ndërmarrjeve e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e huamarrjes për financimin e veprimtarisë së tyre. Ky tregues është 77% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 85% e ndërmarrjeve të mesme dhe 87% e atyre të mëdha. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë është rritur për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Pjesa tjetër e përgjigjeve ka rezultuar në balanca neto pozitive për ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha, ndërkohë që ndërmarrjet e vogla paraqesin një balancë negative. Kjo balancë tregon se pesha e ndërmarrjeve që do të preferonin më shumë hua është më e ulët se pesha e atyre që do të preferonin më pak hua për financimin e veprimtarisë për ndërmarrjet e vogla. Referuar kësaj balance në vrojtimin të kaluar, kërkesa për hua paraqitet në rënie për periudhën e analizuar.

Grafik 3.3 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas mjaftueshmërisë së huasë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

4. Struktura e huasë

4.1 Monedha

Sipas monedhës, huamarrja shfaqet relativisht e balancuar. Gjatë periudhës, 60% e ndërmarrjeve të vogla, 65% e ndërmarrjeve të mesme dhe 45% e ndërmarrjeve të mëdha, deklarojnë se huaja e tyre është vetëm në monedhën vendase, ndërsa pjesa tjetër është në valutë (euro dhe/ose dollarë amerikanë) dhe/ose e kombinuar (lekë dhe valutë). Gjatë periudhës, huamarrja në valutë (kryesisht në euro) rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (rreth 41%) dhe më pak nga ndërmarrjet e vogla e të mesme (përkatësisht 36% dhe 31% e tyre). Ky element ndikohet edhe nga monedha në të cilën këto ndërmarrje kryejnë veprimtarinë. Krahasuar me një gjashtëmujor më parë, pesha e ndërmarrjeve me hua në monedhë të huaj ka rezultuar në rënie për të tre grupet e ndërmarrjeve (prej 1 pp për ndërmarrjet e vogla, 18 pp për ato të mesme dhe 3 pp për ndërmarrjet e mëdha).

Grafik 4.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas monedhës së huasë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.2 Marrja e huasë dhe afati i maturimit

Pjesa e ndërmarrjeve që kanë marrë hua në 1-5 vitet e fundit, janë përkatësisht rreth 51% e ndërmarrjeve të vogla, 55% e ndërmarrjeve të mesme dhe 45% e ndërmarrjeve të mëdha. Krahasuar me një gjashtëmujor më parë, kjo peshë ka shënuar rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve (11.7 pp për ndërmarrjet e vogla, 5.4 pp për ato të mesme dhe 5.2 pp për ndërmarrjet e mëdha).

Huamarrja e re, e cila nënkupton huamarrjen në gjashtëmujorin e fundit, deklarohet nga rreth 7% e ndërmarrjeve të vogla, 14% e ndërmarrjeve të mesme dhe 9% e ndërmarrjeve të mëdha. Në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë, pesha e huamarrësve të rinj ka rezultuar në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha. *Qëllimi kryesor i përdorimit të huamarrjes së re ka qenë përballimi i shpenzimeve afatshkurtra* (për 86% e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura) dhe *kryerja e një investimi afatgjatë* (12% e totalit). Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, është rritur ndjeshëm pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua të re për të përballuar shpenzimet afatshkurtra. Afati mesatar i mbetur i huamarrjes ka rezultuar 64.8 muaj për ndërmarrjet e vogla, 64.9 muaj për ndërmarrjet e mesme dhe 62.2 muaj për ato të mëdha.

4.3 Norma e interesit të huasë dhe mënyra e shlyerjes

Lloji kryesor i normës së interesit të huasë më të madhe ekzistues⁹, mbetet norma e pandryshueshme deri në fund të afatit (për 77% të ndërmarrjeve të vogla, 69% e atyre të mesme dhe 77% e ndërmarrjeve të mëdha) **dhe norma e ndryshueshme çdo vit** (për 15% të ndërmarrjeve të vogla, 21% të ndërmarrjeve të mesme dhe 17% të ndërmarrjeve të mëdha). Gjatë periudhës, pesha e ndërmarrjeve që raportojnë hua me normë të pandryshueshme ka rezultuar në rënie në krahasim me periudhën paraardhëse për të tre grupet e ndërmarrjeve. Frekuenca e shlyerjes vijon të mbetet kryesisht mujore, për 81% të ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 75% të ndërmarrjeve të mesme dhe për 78% të ndërmarrjeve të mëdha.

4.4 Forma e kolateralit dhe raporti i mbulimit

Rreth 64% e ndërmarrjeve të vogla, 59% e ndërmarrjeve të mesme dhe 67% e atyre të mëdha, deklarojnë se huaja e marrë është e kolateralizuar vetëm me pasuri të paluajtshme, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve ka përdorur forma të tjera kolateralizimi¹⁰. Ndërkohë, rreth 12% e ndërmarrjeve


⁹ Në rastin e ndërmarrjeve, të cilat kanë më shumë se një hua.

¹⁰ Mjete financiare, dorëzani, garanci të tjera, së bashku me kombinimin e disa formash kolateralizimi, përfshirë edhe kombinimin me pasuritë e paluajtshme.

të vogla, 8% e ndërmarrjeve të mesme dhe 11% e ndërmarrjeve të mëdha, pohojnë se huaja e marrë është e pakolateralizuar. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, pesha e ndërmarrjeve me hua të pakolateralizuar ka vijuar të shënojë rënie për ndërmarrjet e vogla e të mëdha, ndërkohë që vijon të rritet kolateralizimi me mjete financiare dhe dorëzani/garanci për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.


Mbulimi me kolateral vlerësohet edhe në mënyrë të agreguar përmes indeksit të peshuar të përgjigjeve¹¹. Për gjashtëmujorin e parë 2021, ky indeks ka rezultuar 0.49 për ndërmarrjet e vogla, 0.48 për ndërmarrjet e mesme dhe 0.50 për ato të mëdha. Krahasuar me periudhën e kaluar, raporti i mbulimit ka rezultuar më i lartë për ndërmarrjet e vogla.

Grafik 4.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas formës së kolateralit të huasë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.3 Indeksi i mbulimit me kolateral




5. Ngarkesa e huasë

5.1 Vlera e huasë ndaj kapitalit

Gjatë periudhës, vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për 74% të ndërmarrjeve huamarrëse dhe pothuaj e njëjtë me vlerën e kapitalit për 13% të tyre. Raporti "hua/kapital" ka rezultuar më i lartë te ndërmarrjet e vogla e të mesme, ku përkatësisht 26% dhe 34% e tyre shprehen se ky raport është i barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit, duke nënkuptuar një ngarkesë më të lartë me borxh. Për këtë gjashtëmujor, ky raport është rritur për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve (8.2 pp për ndërmarrjet e vogla, 10.8 pp për ato të mesme dhe 1.6 pp për ato të mëdha).

¹¹ Ky indeks merr vlera nga 0 në 1 dhe rritja e vlerës së tij tregon rritje të peshës së mbulimit me kolateral. Koeficientët e peshimit të këtij indeksi, sipas alternativave, janë: "deri në 50% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.25; "50-100% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.5; "100-120% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.75; "mbi 120% të huasë së kolateralizuar" = 1.

Grafik 5.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit hua/kapital



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në nivel sektorial, ngarkesa me borxh është rritur për të gjithë sektorët e analizuar. Ngarkesa paraqitet më e lartë tek ndërmarrjet e sektorit të ndërtimit dhe ato të tregtisë.

Tabelë 5.1 Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve

| Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve | | | | |
|---|----------|----------|---------|--------|
| | Industri | Shërbime | Ndërtim | Tregti |
| 6MII 2019 | 20.4% | 28.0% | 13.4% | 26.5% |
| 6MI 2020 | 16.4% | 22.9% | 19.7% | 22.2% |
| 6MII 2020 | 19.7% | 25.0% | 17.6% | 21.9% |
| 6MI 2021 | 22.3% | 26.5% | 29.9% | 27.0% |


Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2 Shpenzimi për pagesën e huasë

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (76%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të tyre. Pjesa e këtyre ndërmarrjeve ka rënë me 1 pp krahasuar me vërtetimin paraardhës. Barra e pagesës së huasë duket të jetë më e lartë tek ndërmarrjet e mesme, ku pesha e ndërmarrjeve që raportojnë se kjo pagesë tejkalon 20% të të ardhurave, zë rreth 26% të totalit të grupit¹², ndërsa për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha, kjo peshë është rreth 23%. Të pyetura nëse *kostoja e shërbimit të huasë ka ndryshuar* gjatë periudhës, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (rreth 89% e ndërmarrjeve të vogla, 93% e ndërmarrjeve të mesme dhe 92% e ndërmarrjeve të mëdha), pohojnë që ky shpenzim ka mbetur i pandryshuar. Përgjigjet e pjesës tjetër kanë rezultuar në balanca neto pozitive për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke treguar rritje të këtij shpenzimi në raport me të ardhurat. Gjithsesi, kjo balancë është më e ulët në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë për të tre grupet e ndërmarrjeve.


¹² Llogaritur si shumë e peshave të përgjigjeve: "20-50% të të ardhurave", "50-80% të të ardhurave" dhe "mbi 80% të të ardhurave".

Grafik 5.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 5.3 Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës



5.3 Përballimi i kostos së huasë

Për të kompensuar rritjen e kostos së shërbimit të huasë, ndërmarrjet janë mbështetur kryesisht në uljen e shpenzimeve (27%) ose në përdorimin e rezervave të ndryshme (27%). Kjo mënyrë veprimi mbetet në linjë me përgjigjet e ndërmarrjeve lidhur me mënyrën e financimit të veprimitarisë.

Grafik 5.4 Mënyrat e përballimit të kostos së huasë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.4 Ngarkesa me borxh

Ngarkesa me borxh e ndërmarrjeve huamarrëse vlerësohet në rritje përgjatë periudhës, ku vlera e indeksit¹³ për totalin e ndërmarrjeve ka rezultuar 0.63. Krahasuar me gjashtëmujorin e dytë 2020 dhe sipas madhësisë, indeksi paraqet një ngarkesë më të lartë me borxh për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.

¹³ Indeksi llogaritet duke peshuar përgjigjet e ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve, sipas koeficientëve që marrin vlerat: 1 për alternativën "ngarkesë e lartë", 0.5 për alternativën "ngarkesë mesatare" dhe vlerën 0 për alternativën "ngarkesë e ulët".

Grafik 5.5 Indeksi i ngarkesës me borxh të ndërmarrjeve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.5 Pritshmëritë për pagesën e këstit të huasë për gjashtëmujorin e ardhshëm

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (rreth 89%), pavarësisht madhësisë së tyre, nuk presin ndryshim të këstit të huasë në gjashtëmujorin e dytë 2021. Kjo peshë është rritur me 1.3 pp në krahasim me periudhën paraardhëse. Për sa i përket ndërmarrjeve që presin ndryshim të këstit, rezultojnë se ndërmarrjet e vogla presin rënie në këtë drejtim në gjashtëmujorin e ardhshëm. Ndërkohë, ndërmarrjet e mesme e të mëdha shprehin një balancë neto pozitive për periudhën në vijim.

Grafik 5.6 Pritshmëritë mbi ndryshimin e këstit të huasë në gjashtëmujorin e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.


6. Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen¹⁴

6.1 Aksesi në financim

Kërkesa e ndërmarrjeve për kredi ka vijuar të tregojë rënie për periudhën, ku rreth 8% e tyre deklarojnë se kanë aplikuar për financim gjatë gjashtëmujorit të fundit. Kjo peshë është ngushtuar me rreth 3 pp për totalin e ndërmarrjeve në krahasim me vërtetimin e kaluar. Duke e analizuar këtë tregues sipas madhësisë së ndërmarrjeve, rezultojnë se peshën më të lartë për këtë periudhë vijojnë ta kenë ndërmarrjet e mëdha (rreth 12%). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, vërehet një zgjerim mjaft i lehtë i kërkesës për kredi vetëm për ndërmarrjet e mesme (prej 0.3 pp), ndërkohë që ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha paraqesin një ngushtim të kësaj kërkesë (përkatesisht me 1.3 pp dhe 1.7 pp).

¹⁴ Pyetjet e kësaj rubrike i janë drejtuar të gjithë kampionit të ndërmarrjeve, përfshirë edhe ato jo-huamarrëse.


Grafik 6.1 Kërkesa për financim e ndërmarrjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për hua, në shumicën e rasteve, pohojnë kryesisht se nuk e kanë të nevojshme për veprimtarinë që kryejnë. Kjo peshë rezulton më e lartë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke reflektuar kërkesën e tyre të ngushtuar për kredi. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve kanë vendosur të mos aplikojnë, për shkak se procesi u duket i vështirë apo për shkak se e vlerësojnë si më të lehtë huamarrjen nga burime alternative. Të dyja këto arsye paraqiten me rënie për ndërmarrjet e vogla e të mesme në periudhën e analizuar.


Grafik 6.2 Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për kredi sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të pyetur se si do të vepronin nëse nuk do të financoheshin nga bankat, më shumë se 43% e ndërmarrjeve të vogla pohojnë se do të merrnin hua nga burime alternative, por me një rënie prej 3.4 pp në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Ndërkohë, kjo peshë është ulur gjithashtu edhe për ndërmarrjet e mesme (41%) dhe ato të mëdha (38%). Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e ndërmarrjeve pohojnë se do t'i drejtohen sërish një banke apo institucioni tjetër. Pësia e tyre është rritur ndjeshëm për të gjitha llojet e ndërmarrjeve, duke synuar orientimin e tyre drejt burimeve formale të huamarrjes. Pjesa tjetër e ndërmarrjeve pohojnë shtyrje në kohë të planeve të tyre për zgjerim të veprimtarisë, në kushtet e mungesës së financimit. Kjo peshë është ulur për ndërmarrjet e të gjitha madhësive.

Grafik 6.3 Mundësitë e financimit në rast mosfinancimi nga bankat




Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.2 Procesi i huamarrjes dhe marrëdhënia me bankat

Indeksi i vështirësisë së procesit të huamarrjes nga bankat, për periudhën, ka rezultuar 0.38 për totalin e ndërmarrjeve, i pandryshuar në krahasim me periudhën paraardhëse. Ky indeks vijon të mbetet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", për të tre grupet e ndërmarrjeve. Krahasuar me gjashtëmujorin e dytë 2020, niveli i vështirësisë ka pësuar rënie vetëm për ndërmarrjet e mesme.

Grafik 6.4 Indeksi i vështirësisë së marrjes së një huaje nga bankat në vend¹⁵




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Marrëdhënia me bankat, e matur nga indeksi përkatës, vijon të vlerësohet midis nivelit "e rëndësishme" dhe "e domosdoshme". Në këtë gjashtëmujor ka pasur një rënie të këtij indeksi për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, pas një periudhe në të cilën u rrit rëndësia e marrëdhënies me bankat përgjatë pandemisë, periudhë në të cilën kërkesa për kredi paraqitej në rritje.

¹⁵ Ky indeks llogaritet duke peshuar përgjigjet e ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve sipas një koeficienti, i cili rritet me rritjen e vështirësisë së këtij procesi. Koeficienti për alternativën "shumë e thjeshtë" = 0, "normal" = 0.25, "i vështirë" = 0.5, "shumë e vështirë" = 0.75, "pothuaj i pamundur" = 1.

Grafik 6.5 Indeksi i rëndësisë së marrëdhënies me bankat¹⁶




Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.3 Vështirësia e përfitimit të huasë¹⁷

Megjithëse në rënie, **kostoja e kredisë vijon të konsiderohet si elementi kryesor që vështirëson përfitimin e një huaje bankare, në mënyrë më të theksuar për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme.** Për këtë gjashtëmuor, vlerësimi për këtë element ka rezultuar në rënie për ndërmarrjet e mesme dhe ato të mëdha. Në vijim të kostonë së kredisë, edhe **kostoja e plotësimit të kërkesave të bankës** vijon të mbetet një vështirësi e konsiderueshme për të tre grupet e ndërmarrjeve, ndjekur nga vlerësimi për **kushtet e garantimit të kredisë dhe paqartësia e kërkesave të bankës dhe procedura burokratike.** Për këto elemente, ndërmarrjet e vogla shprehin një vështirësi më të lartë për periudhën e vrojtuar.

Grafik 6.6 Niveli i vështirësisë së përfitimit të një huaje



Burimi: Banka e Shqipërisë.


¹⁶ Ky indeks llogaritet duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve, sipas koeficientëve që marrin vlerat: 1 për alternativën “e domosdoshme”, 0.5 për alternativën “e rëndësishme” dhe vlerën 0 për alternativën “jo dhe aq e rëndësishme”.

¹⁷ Për të vlerësuar vështirësinë e përfitimit të një huaje bankare, ndërmarrjeve iu është kërkuar të japin gjykimin e tyre për një sërë elementesh cilësore, sipas një sistemi vlerësimi me 5 shkallë, ku shkalla më e ulët e vështirësisë është 1 dhe shkalla më e lartë është 5. Për të marrë një vlerësim mesatar për secilin element cilësor, shkallët e vlerësimit nga 1 në 5 peshohen me peshat e përgjigjeve të dhëna nga ndërmarrjet.

6.4 Planifikimi i huamarrjes


Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmujorin e ardhshëm, bazuar në përgjigjet e ndërmarrjeve, gjykohet se kërkesa për kredi paraqitet në tkurje. Thuajse gjysma e ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit deklarojnë se *"nuk ka asnjë mundësi"* që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme. Kjo peshë ka shënuar rritje për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve në krahasim me periudhat paraardhëse. Nga ana tjetër, vërehet një rritje e peshës së këtyre ndërmarrjeve që pohojnë se *"ka pak mundësi"* të marrin një kredi në gjysmën e dytë të vitit 2021, si edhe e peshës së ndërmarrjeve të vogla e të mëdha të cilat shprehen se *"ka shumë mundësi"* që diçka e tillë të ndodhë në periudhën pasardhëse. Peshat e ndërmarrjeve të cilat kanë zgjedhur alternativën *"është e sigurt"* është rritur lehtësisht për ndërmarrjet e të gjitha madhësive, ndonëse kjo zgjedhje ruan peshën më të vogël. Indeksi i vlerësimit të planifikimit të huamarrjes për gjashtëmujorin e ardhshëm¹⁸ rezulton në nivelin 0.4 për totalin e ndërmarrjeve. Ky indeks paraqitet i tkurrur për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, por në mënyrë më të theksuar për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha.

Grafik 6.7 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të huamarrjes



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.8 Indeksi i planifikimit të huamarrjes



¹⁸ Për të vlerësuar përgjigjet e ndërmarrjeve është ndërtuar indeksi mbi planifikimin e huamarrjes, llogaritur duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve sipas një koeficienti, i cili rritet me rritjen e mundësisë së huamarrjes. Koeficienti për alternativën: "nuk ka asnjë mundësi" = 0.25; "ka pak mundësi" = 0.5; "ka shumë mundësi" = 0.75; "është e sigurt" = 1.